



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Nr. 17309/1 Prot

Lezhë, më 08.09.2026

RINJOFTIM

PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME PROJEKT-DOKUMENTIN E PBA-së 2027-2029 DHE BUXHETIT VJETOR 2027 (FAZA E DYTË)

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen Vendore” si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, i ndryshuar, **ju njoftojmë për zhvillimin e dëgjesës publike në lidhje me PROJEKT-DOKUMENTIN E PBA-së 2027-2029 DHE BUXHETIT VJETOR 2027 (FAZA E DYTË).**

Dëgjesa publike e parashikuar për t’u zhvilluar **në datën 10.09.2026**, në orën 16:30, në Pallatin e Kulturës “Ded Ndue Lazri”, Lezhë, do të zhvillohet **në orën 11:00, në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Gjergj Lacaj” Lezhë**, në koordinim me administratën e Bashkisë Lezhë.

Rekomandimet mund t’i dërgoni në adresën e emailit të Sekretarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë florida.cunaj@lezha.gov.al ose nëpërmjet shërbimit postar, deri me datë 10.09.2026.

